



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-12766  
Datë 21.06.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 65 dhe 69 paragrafi 3 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Vendimin e Inspektoratit të Arsimit me referencë 10/02 dhe numër protokolli 337/2023 të datës 31.05.2023 dhe kërkesën numër 04-290 nga Drejtorja e Arsimit, nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. Nëpunësit Agim Morina nga Gjakova, i sistemuar Drejtor i SHML Gjinnazi "Asllan Berisha" i vazhdohet kontrata e punës në pozitën e Drejtorit në të njëjtin institucion për periudhën kohore katër (4) vjeçare, nga data 01.06.2023 deri me datë 31.05.2027 respektivisht deri në arritjen e moshës së pensionimit më datë 05.04.2025.
2. Kompensimi i pagës mujore të bëhet në lartësi të koeficientit të paraparë për pozitën e Drejtorit të SHML.
3. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

### A R S Y E T I M

Nëpunësit Agim Morina, i sistemuar Drejtor i SHML Gjinnazi "Asllan Berisha" pas vlerësimit të performancës dhe rezultateve të mira të punës në menaxhimin e shkollës, u rekomandua që t'i vazhdohet kontrata e punës në pozitën e Drejtorit në të njëjtin institucion për periudhën kohore katër (4) vjeçare, respektivisht deri në arritjen e moshës së pensionimit.

Bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 65 dhe 69 paragrafi 3 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Vendimin e Inspektoratit të Arsimit me referencë 10/02 dhe numër protokolli 337/2023 të datës 31.05.2023 dhe kërkesën numër 04-290 nga Drejtorja e Arsimit, z Agim Morina i vazhdohet kontrata e punës sipas dispozitivit të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 15 ditësh, prej ditës së pranimit të te njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

**Vendimi iu dorëzohet:** Nëpunësit Agim Morina, Drejtorisë për Arsim, Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit.

Ardian Gjini  
për  
Kryetar i Komunës së Gjakovës